



Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 47 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi Komunal i Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt. 29.01.2010, bjen këtë :

V E N D I M

MBI FORMIMIN E KOMITETIT TË KOMUNITETEVE

I.

Formohet Komiteti i Komuniteteve pranë Kuvendit Komunal të Deçanit në këtë përbërje:

1. Sefadin Sadriaj, K/E, Gramaqel,
2. Qamil Hoti, K/E Pemishte,
3. Gjeve Belaj, K/R, Shaptej,
4. Vesna Spaleviq, K/S, Deçan,
5. Hedije Kuçi, K/B, Deçan
6. Fatime Tishukaj,
7. Naile Alaj.

II.

Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për tu siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për tu avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

III.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Me Vendim njoftohen:

-Të emruarit në pikën I. Të Vendimit dhe

-Arhivi.

01.Nr.II-3

Deçan,dt.29.01.2010

K r y e s u e s i:
Jashar Dobraj